



# LUFTË QELBËSISH

## Mendim Sfida

Shqiperia ka hyrë në vitin e njëzet e dytë të një lloj lufte të paparë më parë, as në rrafshin social e, as në atë politik. Me datën 02.03.2012 shqiptarët e kudondodhur perkujtuan njëren nga ngjarjet kulmore te historisë së Kombit tonë, atë të BESËLIDHJES shqiptare, midis princërve të Principatave shqiptare te kohës, ndodhur me 1444 në të njëjtën datë, në qytetin e lashtë të Lezhës, nën drejtimin e prijësit me permasa legjendare, Gjergj Kastriotit – SKENDERBEUT.

“Lufta” e sotme politike, në Shqipëri, me nuancë të theksuara mafioze, kriminale e anti shqiptare, që zhvillohet midis grupacioneve të të njëjtës specie politike (klasës politike që përfaqëson e mbron interesat e borgjezisë), e ndarë formalisht në dy krahë, në të “majtë” e, në të “djathtë” , e ka drobitur e çuar në kufijtë e hamendësisë hamletjane këtë vend e këtë popull, krejt të pafajshëm për këtë që pësoi në keto më se dy dekada, pas vitit 1990. Në legjendat e në mitologjinë e kombit tonë kemi lexuar e “parë” me sytë e mendjes lloj – lloj ndodhishë, hasmerishë, lufrash e qendresash, që kishin pamje vigane, burrërore, fisnike, sepse frymëzoheshin nga një lejtmotiv i brendshëm njerëzor, nga parimi i madh i ruajtjes së ekzistencës e vijimësisë së jetës së kësaj rrace njerëzish që më vonë do të formonin KOMBIN tonë, sa të lashtë aq edhe heroik në rrezistencën e vet për mbijetesë, në këto troje ku natyra e vendosi atë të parin.

Qendrestarët, në krye të qendresave të vazhdueshme, nëpër rrugëtimin tonë të stermundimshëm rrugëve të gjata të historisë, s’e di se përse na ngjajnë sot, kur lexojmë për ta, si luanë, si kreshnikë, si të mbinatyrshëm(!)

Ç’i bën këta qendrestarë të tillë? Si arriten të ravijëzojnë në kujtesën e kombit, përfytyrimin e tyre prej prijësish, që në thelbin e ndergjegjes e te moralit të tyre kishin vlerat njerëzore, vlerat e racës së tyre, vlera që edhe i pasuruan e ua dhanë brezave si balsam shpirtor për të arritur deri në këto dy dekadat e fundit, dekada shumë tronditëse për Kombin, dekada ku shpesh e më shpesh hidhet baltë e helm mbi vlerat tona nga disa specie politike, që më ngjasojnë me kafshën e qelbësit.

Në qoftë se i përballim dy kampet e drejtuesve të qendresës tonë, në përgjithësi, dukshëm ata ndahen në dy kampe thelbësisht të ndryshme e, logjikshëm të kundërt. Qendrestarët ilirë shkelqyen me vlerat që ia dhanë racës tonë, por edhe popujve të tjerë. Po kështu ata të arbërit, në Mesjetë, me

Skenderbeun në krye, e ngriten shumë më lart dinjitetin e nderimin për racën tonë.

Rilindësit e mëdhenj të Kombit tonë, formuan e frymëzuan një lëvizje të pashembullt për nga vlerat e gjithanshme morale, kulturore, organizative e luftarake, levizje e cila zgjoi ndergjegjen e shqiptarëve dhe ndihmoi në formimin e kombit tonë. Ajo e ndezi flakën e atdhetarisë që s’do të shuhej më kurr, në shpirtin e këtij kombi, si vullkanin e qendresës kundër pushtuesve shekullorë osmanë. Falë frymës së kësaj Levizjeje, kombi ynë arriti në ditën e madhe të **28 Nëntorit të vitit 1912**, ditë që shënoi **MËVETËSINË** e trojeve e të kombit tonë, nga sundimi i gjatë osmman. Përpjekjet e qendrestarëve shqiptarë vazhduan edhe më të mëdha, edhe pse kombi ynë fitoi Pavarësinë, sepse fqinjët shovenë, por edhe Europa plakë, si në mëndime edhe në veprimet e qendrimet e saj ndaj nesh, po tregonin një armiqësi krejt të palogjikshme, një armiqësi që ushqeje nga atavizmat e mendimit të nxjerrë nga skutat e errëta të mendësive primitive gjysmënjerëzore .(!) Kuptohet se edhe deri ketu, qendresa jonë kombëtare nuk kishte vetem kundërshtarë “të jashtëm”, por, fatkeqësisht, edhe nga ata të brendshmit. Vitet e periudhës së Pavarësisë, 1912 – 1939, janë vite ku antivlerat e gjithfarëkuptimshme, në vend, të ndihmuara edhe nga ato të shovinizmit rreth e qark nesh, por edhe te Europës shpirtplakë, lanë “në fuqi” dhe i dhanë “pasaportë” njohjeje, masakrës më të madhe që i është bërë ndonjë herë truallit e Kombit tonë, coptimit të tyre e, shperblimin me to të këtyre shteteve fqinjë. Thashë, “*i dhanë pasaportë*”, sepse kjo dukuri vazhdoi edhe nga “qendrestarët” pseudoshqiptarë kundër qendresës e qendrestarëve të vertetë shqiptarë, vetem për të hypur në karrigen apo fronin e pushtetit dhe, kur janë rrëzuar prej tyre, kanë shperblyer miqtë e tyre serbë, me pjesët më të bukura të viseve shqiptare, siç janë ato të Vermoshit, Shën Naumit, vetem e vetem për t’i rihypur edhe një herë në atë fron të ngritur mbi “vlerën” e tradhëtisë kombëtare. Rihypja në fron e antishqiptarit A.Zogu, i kushtoi shumë shtrenjtë kombit, sepse ai, më pabesi e dinakëri, me duarë vrastare, eliminoi njërin pas tjetrit qendrestarë tëvertetë e të lavdishëm të shpirtit të kombit, siç ishin korifejtë Hasan Prishtina, Bajram Curri, Avni Rrustemi, Luigj Gurakuqi e shumë e shumë të tjerë prijës e mentarë të popullit nëpër krahina të ndryshme të vendit.

Qendresa e vazhdueshme e kombit tonë, ka ngjarë gjithnjë si një qendresë midis luanëve, nga njëra anë e, ujqërve, çakejve, dhelprave e qelbësve, nga ana tjetër, ku këta të grupit të dytë, të ndihmuar vazhdimisht nga faktorët e jashtëm joshqiptarë, armiq të tyre, deri me 07 prill 1939 e dhunuan së tepërmi kombin e trojet kombëtare, i turpëruan ata dhe më në fund edhe iken me bishtin nën shalë, por më valixhet plot me ar, duke lënë kombin e vendin në mëshirën e fatit, përballë pushtimit fashist të vendit.

Shpirti i kombit tonë ka qënë e është aq i madh, sa në vlerat e tij nuk shterron kurr. Ai i rilindi, i rriti e i vuri në ballë të qendresave historike qendrestarët e nderit, ata që do t'ia lartësonin përseri emrin, nderin e dinjitetin kombit tonë.

E, periudha e lavdishme e LANÇ shqiptare është një deshmi e gjallë që flet edhe sot e gjithmonë, me krenari për vlerat që lindi, frymëzoi e rriti, duke i bërë ato, pjesë të shpirtit të madh të kombit. Tashmë epoka historike do të fliste me gjuhën e vlerave, me gjuhën e qendrestarëve luanë, deshmorëve e heronjëve të kombit, lirisë e Atdheut. *LANÇ shqiptare, pati fatin e madh historik që në krye të kësaj lufte, historia vuri birin më të lavdishëm, prijësin që s'njohu kurrë humbje e, s'i dha kurrë humbje kombit të vet, strategun mendjehollë të artit të fitores mbi armiqtë e shumtë të kombit, luftëtarin e paepur me pushkë në dorë, zemerzjarrtin si zemra e Diellit, farkëtonjësin e fitores mbi koalicionin pushtueso – tradhëtar, nazifashizmin e bashkëpunëtorët e tyre ballisto – zogistë, mendjendriturin që ia ndriçoi rrugën e lirisë kombit të vet, politikanin e diplomatit brilant, trim e të urtë, si urtësia e kombit që i përkiste, largpamësin që me zgjuarësi diti ta drejtojë luftën e qendresën popullore e kombëtare, në krahun e fitimtarëve të mëdhenj të Globit, lavdimadhin udhëheqës, shokun ENVER HOXHA.* Që nga kjo kohë, tashmë Shqiperia dhe dhqiptarët do të flitnin me gojën e zërin e tyre, do të ecnin ballëlart e me plot dinjitet, përkrah kombeve të tjerë, si të barabartë mes të barabartëve e, të rrespektuar ngado. Ujqërit, çakenjtë, dhelprat e qelbësit do të iknin së bashku me mbeturinat e pushtuesve, për të ulëritur, kuitur, ndotur e qelbur vendet ku i strehuan, me shpresën se do t'i rikthenin përseri në Shqiperi, për të përmbysur pushtetin e luanëve trima partizanë e, të një populli fitimtarë mbi ta .

Për afro pesë dekada në krye të Shqiperisë e të shqiptarëve qendroi një pushtet krejt i veçantë për shqiptarët, sepse nuk e kishin as parë e, as menduar se si mund të funksiononte. Ai pushtet quhej me emrin kuptimplotë, "***Pushteti Popullor***" e, forca politike që e frymëzonte dhe e udhëhiqte nga fitorja në fitore ishte ***PKSH ose Partia e Punës së Shqiperisë, mishëronjësja e të gjitha vlerave më të mira njerëzore, të trashëguara brez pas brezi, të Kombit tonë.*** Ky pushtet ishte i popullit, shprehte e mbronte interesat e shumicës e, drejtohej nga luanët që i lindi nga gjiri i vet populli. Ai pushtet e pastroi Shqiperinë nga mbeturinat e gjithfarëllojshme, si ato: politike, fetare, prapanike, inkuizicioniste, psikologjike, morale, kulturore, emancipuese e ato të të ndjerit të vetes inferior ndaj të tjerëve.

***Politika dhe pushteti i politikës së "luanëve" komunistë kishin në qender te veprimtarisë së vet plotësimin gjithnjë e më shumë, si edhe më mirë, të nevojave gjithmonë në rritje të popullit e, rritjen e nivelit të jetesës së tij, duke luftuar regresin në mendim, në zhvillim, në psikologji e, në anën morale e shpirtrore.*** Tashmë fytyra e Shqiperisë socialiste nën udhëheqjen e PPSH e të

Enver Hoxhës, kishte pësuar aq ndryshime pozitive, sa as ëndrrimtarët më të mëdhenj të të gjitha kohërave nuk mund ta kishin menduar. Kjo kishte ndodhur si pasojë e një të gjykuari objektiv për natyrën e një shteti e të pushteteve që i japin forcë atij.

***Kur shteti e pushtetet vihen në sherbim të popullit, s'ka forcë që mund t'i pengojë sukseset e padiskutueshme e te gjithanshme te tyre, në dobi të shumicës së popullit*** . Ky shkrim nuk është objekti i ballafaqimit të dy botëve, asaj socialiste e kësaj borgjeze, në Shqipëri, por këtu dua të ndalem në natyrën e luftës politike, psikologjike, morale, kulturore, ekonomike, sociale, ushtarake që është zhvilluar në këto njëzet e dy vjetë që nga koha kur u restaurua sistemi kapitalist në Shqipëri, pra që nga viti 1990.

Sistemi kapitalist, nën petkun e luftës për mbrojtjen e të drejtave e të lirive të njeriut, në fakt i vrau ato, përmes pjelljes së një numri të pakontrolluar forcash politike të ashtuquajtura “parti” e, që ndaheshin si me short në “të majta” e, në “të djathta”. Kështu u sherbenin më mirë interesave të padronës borgjezi, vendase e, asaj të huaj, që i dirigjonte e i dirigjon në çdo hap të veprimtarisë së tyre përçarëse e antikombëtare. Klasa politike e ketyre viteve e degradoi jetën njerëzore në vlerat e saj, sa ajo tashmë ngjan me gjithçka, por me jeten e moralin e shëndoshë njerëzor të kombit tonë, jo. Një jetë e tillë e zvenitur në vlerat e saj, një ekonomi e rrenuar përfundimisht dhe e asfiksuar për të bërë qoftë dhe një hap përpara, një shoqëri e ndarë në parcela politike, e përçarë nga grindjet, nga hasmëritë e reja, nga vëllavrasjet e gjakmarrjet e kohës “demokratikase” borgjeze; një vend i kthyer në gjysmëshkretëtirë nga çpopullimet e pakontrolluara, nga shkatërrimet me “aksion me goditje të përqendruar” të të gjithë infrastrukturës së ngritur për më se një gjysmë shekulli, me punën, mundin, djersën por edhe gjakun e një populli; një jetë pa perspektivë, pa shpresa, pa burime jetese e, pa mundësi për të vënë në veprim të gjitha resurset e shumta e te gjithanshme që ka vendi e shoqëria; një popullsi me moshën më të re në Europë që degdiset udhëve të kurbetit e atyre në vend tmerrësisht e papunë; një fytyrë e zbehtë e kësaj Shqipërie që dergjet tash dy dekada si në bregun e varrit, ku s'ka një politikë që t'ia afrojë mundësinë e sherimit e të shpetimit nga vdekja e sigurtë; një shthurje e degradim i pakonceptueshëm i qelizës bazë të shoqërisë, familjes, shthurje e degradim që përhapet si një metastazë kancerogjene në të gjithë shoqërinë; një kriminalitet i patrembur e nje pasiguri teper e sigurtë në veprimtarinë e vet, në dëm të jetës e cilësisë së saj, janë fytyra e ngjyra e shtetit e pushteteve të QELBËSVE e të politikave të tyre qelbanike antikombëtare. Sot qelbësit pushtetarë janë gati të shesin e, pse jo edhe të falin, çdo interes që ka të bëjë me kombin e Atdheun, vetem e vetem që karrigja e pushtetit të tyre të qelbur të mos u ikë. Në këto dy dekada nuk kemi degjuar asnjëhere një mendim progresist që t'i sherbejë kombit, por jemi sterngopur e helmuar shpirtërisht nga fyerjet, shpifjet, sharjet, nga tonelatat e

baltës politike derdhur pa kontroll nga “gojët” nevojtoje të qelbësve, aq sa na e kanë neveritur e pështirosur konceptin për jetën në këtë sistem antivlerash njerëzore.

Lufta e qelbësve politikë shqiptarë në këto dy dekada, e ka rrënuar e pamundësuar vazhdimësinë e jetës në vend, e ka bllokuar kerkimin e mundësive që të çojnë drejt shpetimit për shumicën e popullit, e ka kthyer Shqiperinë gati në një gjysmëkufomë në të cilën të gjithë këta qelbës, së bashku e individualisht, me të gjitha mënyrat më çnjerëzore, shqyejnë e grabitin nga ato që i kanë mbetur trupit të rrënuar prej tyre, të kësaj Shqiperie të mjerë. Ndotja morale, politike, natyrore, psikologjike e kulturore në vend ka ardhur nga pushteti i këtyrë qelbësve politikë që ndotin gjithçka e në çdo kohë. Lufta e qelbësve pushtetarë të pasnëntëdhjetës, në Shqiperi, ka ndotur edhe “aromën” politike të “aleatëve” euro-atlantikë, aq sa asnjëri prej tyre nuk ka dëshirë që të merret me problemet e Shqiperisë, të shkaktuara nga qelbësit qeverisës të të tëra ketyre viteve të dy dekadave të fundit. Duke parë këtë “Luftë qelbësish” në Shqiperi, ku edhe qelbësit hahen e kacafyten me njëri – tjetrin, “partnerët” kujdestarë për Shqiperinë, nuk bëjnë gjë tjetër veç se u japin, nga larg, vazhdimisht “detyra shtepie” e, ku asnjëherë nuk shikojnë një detyrë të përfunduar, por në vend të një rezultati të kënaqshëm, ata, “partnerët”, shikojnë zhgarravinat e padeshifrueshme e, degjojnë zhurmat llomotitëse të qelbësve “politikanë”, ku s’kuptohet asgjë e, s’degjohet asnjë mendim i qartë shpetues, për vendin e derguar në buzë të varrit prej tyre.

Po e perfundoj këtë shkrim duke rikujtuar edhe një herë 568 – vjetorin e BESËLIDHJES shqiptare të Lezhës, misionin e qellimit, detyrat e moralin e saj.

E di se duke e perballur atë ngjarje heroike më kohën e sotme, mund edhe ta fyej, por nuk është ai qellimi i këtij shkrimi. Koha e sotme ka brenda saj edhe 100 – vjetorin e MËVETËSISË së SHQIPERISË, pra të shtetit shqiptar. ***Ky jubile duhet të trokasë fort në ndergjegjen tonë politike e sociale, individuale e kombëtare, sepse ende nuk e kemi arritur përfundimin e detyrës që na lanë brezat e deshmorëve e të heronjve të të gjitha kohërave, ëndrrën e atyre që vdiqën pa e parë me sy të jetësuar atë, RIBASHKIMIN e trojeve tona e të kombit tonë në një shtet e nën një FLAMUR.*** Bashkimi është i mundur, sepse atë e vertetoi Besëlidhja që realizuan shqiptarët nën udhëheqjen e Skenderbeut, e vertetuan përseri shqiptarët nën udhëheqjen e Enver Hoxhës. Duke bërë luftë qelbësish, kurr nuk mund të arrijmë tek BASHKIMI KOMBËTAR, prandaj që ta arrijmë atë, duhet t’i largojmë qelbësit dhe politikat e tyre të qelbura nga skena politike, kudo në trojet shqiptare.